



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:015006

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03218099

P. nr.102/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtarja Diana Sina dhe me zyrtaren ligjore Kaltrina Halilaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.M. nga Gj., për shkak të veprës penale, Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.140/22, të datës 08.03.2022, në shqyrtimin fillestar, të mbajtur më datën **08.06.2022**, në prani të Prokurores së shtetit Mone Sylja, të akuzuarit, mbrojtësit të tij av.Agim Muhaxheri, me autorizim në lëndë, si dhe të dëmtuarës F.B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 15.06.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **F.M.**, i biri i R. dhe nënës N., e gjinisë I., i lindur me... në Gj., ku edhe tani banon në rrugën..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: nga muaji Gusht i vitit 2021 e gjer me 24.01.2022 në Gjakovë, i akuzuari F.M., përfshihet në sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit të dëmtuarës F.B., në atë mënyrë që e dëmtuara kishte ndërprerë lidhjen e dashurisë me të akuzuarin, i akuzuari me fjalë banale “Kurv mos më shtinë mu bo kriminel, ti s’ki mu kon me kërkon tjetër, s’ka me t’lon rahat”, si dhe duke tentuar ta mbaj në kontroll duke e kërcënuar familjen e saj, duke i shkuar tek shtëpia, vendi i punës si dhe duke i shënuar SMS në rrjetin social si “Kurv ty kam me t’pre, kriminel jam o budall, ki me pa t’hanën se kush jam unë, dije çka është krimineli të betona n’Zot, e jetën kam me ta nxi”, “keni 24 orë afat që të më kthehesh mua ose do ti vras të gjithë” e shumë SMS tjera, me çka tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë shqetësim dhe ankth për jetën e saj.

-Me çka ka kryer veprën penale Ngacmimi, nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të neneve 4,7,17 par.1, 38, 39, 40 ,43, 69, 70, 71par.1 nënpar.1.2, 79 dhe nenit 182 par.1 të KPRK- së, si dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

1 (5)

Dënim me gjobë në shumë prej **1.200.00.-€ (një mijë e dyqind euro)**, në të cilën dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim në kohëzgjatje prej 39 ditësh, duke llogaritur nga data 24.01.2022 gjer me datë 04.03.2022, ashtu që për çdo ditë të kaluar në paraburgim llogaritet nga **20.00 (njëzet) euro** të gjobës, që i bie **780.00.-€ (shtatëqind e tetëdhjetë euro)**. **Pjesa e mbetur e dënimit me gjobë në shume prej 420.00.-€ (katërqind e njëzet euro)**, i akuzuari është i detyruar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e mbetur, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë në shumë prej **420.00.-€ (katërqind e njëzet euro)**, do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **21 (njëzet e një) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.00.-€ (njëzet euro) të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që të paguajnë shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej **30.00 euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej **30.00 euro**, e krejt këto në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara F.B. nga fshati N., Komuna e Suharekës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë aktakuzën me numër PP/II.nr.140/22, të datës 08.03.2022, kundër të akuzuarit F.M. nga Gj., për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

Me aktvendimin PPr.nr.23/22 të datës 26.01.2022 Gjyqtarja e procedurës paraprake ka marr aktvendim me të cilën ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II.nr.140/22 të datës 25.01.2022 dhe të pandehurit F.M. nga Gj., për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, i ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1) muaji, nga data 24.01.2022 gjer me datë 24.02.2022.

Me aktvendimin PPr.nr. 23/22 të datës 24.02.2022 Gjyqtarja e procedurës paraprake ka marr aktvendim me të cilën ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me PP/II.nr. 140/22 të datës 23.02.2022 dhe të pandehurit F. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një (1)muaji, nga data 24.02.2022 gjer me datë 23.03.2022.

Me aktvendimin PPr.nr.23/22 të datës 04.03.2022 Gjyqtarja e procedurës paraprake ka marr aktvendim me të cilën ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm me PP/II.nr. 140/22 të datës 04.03.2022 dhe të pandehurit F. M. nga Gjakova, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së, i ka ndërprerë masën e paraburgimit dhe menjëherë është lëshuar në liri me datë 04.03.2022.

Prokuroria Themelore në Gjakovë me datën 10.03.2022 pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë me PP/II.nr.140/22 për të akuzuarin F.M. nga Gj. për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

Pas pranimit të lëndës P.nr.102/22 Gjyqtarja e vetme gjykuese ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 08.06.2022, kundër të akuzuarit F.M. nga Gj., për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari F.M., në prezencë të mbrojtësit të tij av. Agim Muhaxhiri, lidhur me fajësinë ka deklaruar se: pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim, i cili paraprakisht më ka sqaruar pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohem ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, për të cilën vepër jam penduar pa masë duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, shton se në atë kohë kam qenë në gjendje të rëndë emocionale, kam qenë shumë i dashuruar me të dëmtuarën dhe nuk kam qenë në gjendje që të i kontrolloj veprimet e mia, shfrytëzoj rastin që edhe publikisht të i kërkoj falje këtu të dëmtuarës F.B., duke i premtuar se nuk do ta përsërisë më veprimet e tilla. Shton se jam në gjendje të dobët materiale, për momentin jam i papunë, asnjëherë më parë nuk kam ra ndesh me ligjin, kjo është hera e parë që paraqitem para gjykatës për një vepër të kryer penale por premtoj se kjo do të jetë edhe hera e fundit, andaj i propozoj gjykatës që të merr parasysh rrethanat e lartpërmendura me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.M., av. Agim Muhaxhiri lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë meqenëse paraprakisht i mbrojturi im ka marrë në dijeni nga unë të gjitha benefitet ligjore me pranimin e fajësisë, kërkim faljen dhe premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisë të njëjtën vepër. I njëjti ka qëndruar në paraburgim, kërkoj nga gjykata që paraburgimi dosido ligjërisht do të i llogaritet në dënim dhe të mos i shqiptohet dënim tjetër për shkak të benefiteve ligjore të pranimit të fajësisë, është i ri dhe çfarëdo dënimi në të ardhmen nuk do të ndikojë më tepër se që ka ndikuar qëndrimi në paraburgim, i njëjti e ka arritur qëllimin me vet sjelljen dhe pranimin e fajësisë. Kërkoj nga gjykata që si rrethana lehtësuese të trajtohen e gjitha ajo çka u tha më lartë.

E dëmtuara F.B. ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi. Shton se i akuzuari nuk e ka shqetësuar që pas këtij momenti dhe nga vet fakti se i njëjti është vetëdijësuar dhe ka premtuar se një veprim të tillë nuk do ta përsërisë, si dhe i njëjti më ka kërkuar falje menjëherë pas rastit, edhe tani publikisht më kërkoj falje, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtit të i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurorja e Shtetit Mone Sylja ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit F.M., pasi që në këtë shqyrtim fillestar e ka pranuar fajësinë duke i ditur që më parë pasojat dhe favorët e pranimit të fajësisë, dhe këtë pranim deklaroi se e ka bërë në mënyrë të vullnetshme dhe me vetëdije të plotë, atëherë në këtë fazë të shqyrtimit deklaroi se aktakuza është e ndërtuar në prova dhe duke përmbushur figurën e veprës penale nga neni 182 par.1 të KPRK-së dhe shtoi se me rastin e shqiptimit të dënimit përpos të gjitha rrethanave lehtësuese që u përmenden më lartë, gjykata të ketë parasysh edhe rrethanat rënduese siç është ngacmimi i vazhdueshëm, traumat familjare që i kanë përjetuar e dëmtuara edhe familja e saj, këto rrethana gjykata të i ketë parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si dhe gjykata ta obligojë edhe në pagimin e shpenzimeve procedurale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari F.M. nga G., për shkak të veprës penale, Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së ,nga se ka ardhur në përfundim se

pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale, që i vihet në barrë, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, andaj ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të akuzuarit. Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë gjykata konsideron se nuk do të ketë procedurë të provave e as fjalë përfundimtare.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtarja e vetme gjykuese ka vërtetuar këto gjendje faktike se:

I akuzuari F.M. nga Gj. ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 182 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Ngacmimi e kryen “*kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmeve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me jobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*”

5. Vendimi për shpalljen fajtor të akuzuarit

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykues konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpallë fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marr për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet tejet korrekte në Gjykim, sjelljet

e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekt qytetar i rëndomtë dhe asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, më parë nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personaliteti i tij që për Gjykatën është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojën e shkaktuar, është penduar thellë për veprën penale të kryer, premtimin që të dëmtuarën në të ardhmen nuk do ta shqetësoj, kërkim falje publike të dëmtuarës. Ndërsa si rrethana rënduese Gjykata morri parasysh rrethanat në të cilën është kryer vepra penale ,peshën e veprës të kryer. Andaj duke marrë parasysh këto rrethana gjykata të njëjtin e gjykoj me dënim të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

8.Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par.2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.102/2022 me datën 08.06.2022

Zyrtarja ligjore
Kaltrina Halilaj

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.